Këto ndikime janë specifike për një lokacion të caktuar-specifik; disa, nëse ekzistojnë, nga ata janë të pakthyeshme; dhe në shumë raste masat për zbutje mundet të jenë të dizenuara jashtë nga ato që bëjnë pjesë në nën-projektet e kategorisë A. Përfshirja e dokumentit për vlerësim të ndikimit për nën-projekt të kategorisë B mund të variojë nga një nën-projekt në tjetër. Në këtë rast, VN i provon ndikimet pozitive dhe negative të nën-projektit dhe rekomandon masa të nevojshme që të parandalohen, minimizohen dhe zbuten ato ndikime negative. Kategoritë e Vlerësim të ndikimit janë të domosdoshme për t'i vlerësuar ndikimet potenciale negative që janë të lidhur me nën-projektin e propozuar, përmes identifikimit të përmirësimeve potenciale mbi mjedisin jetësor dhe masat e nevojshme që të parandalohen, minimizohen dhe zbuten ato ndikime negative. Shkalla dhe forma e dokumentit për vlerësim të ndikimit do të variojnë në varshmëri nga nën-projekti, por zakonisht do të jenë në nivel më të ulët se Studimi për vlerësim të ndikimit mbi mjedisin jetësor, zakonisht në formë të Planit për menaxhim me mjedisin jetësor dhe ndikimet sociale. Për nën-projektet e kategorisë B+, shfrytëzuesi është përgjegjës për përgatitje të VNMJ-së së plotë ose në rastin konkret, VNMJ ose PMMJ të zvogëluar, për çka është e nevojshme përshkrim i shkurtër të ndikimeve dhe përcaktim të masave mirë të definuara për zbutje dhe pranim të praktikave të pranueshme për veprim dhe monitorim. Shpenzimet për masat për zbutje do të përfshihen ose në dokument të mëvetëm të PMMJ-së ose në dokument të atillë, i cili është pjesë e VNMJ-së dhe do të inkorporohet në përlllogaritje.

**3.3. DEDIKIMI I PLANIT PËR MENAXHIM ME MJEDISIN JETËSOR – SHPALLJE PUBLIKE DHE KONSULTË PUBLIKE**

Qëllimi i PNMJ-së për nën-projektin “Struga – Destinacioni juaj turistik” i Komunës së Strugës, është që në kohë të identifikohen ndikimet mbi mjedisin jetësor që do të dalin nga realizimi i aktiviteteve të planifikuara projektuese, për të cilat janë propozuar masa për zbutje ose minimizim, të kahzuara drejt mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe periudhës kohore për realizim të atyre masave, me persona përgjegjës për zbatim të Planit dhe për shpenzimet e parashikuara. PNMJ-ja e përgatitur për nën-projektin e propozuar do të jetë pjesë e Kontratës me Realizuesin, i cili është i obliguar që t'i ndër marrë masat e parashikuara në pajtim me Planin për zbutje. Inxhinjeri mbikëqyrës është i obliguar që ta ndjekë dhe ta vlerësojë zbatimin e masave të propozuara sipas Planit për mbikëqyrje dhe ta informojë Investuesin dhe Zyrën e Projekteve (Komunën e Strugës dhe Projektin për Konkurrencë Lokale dhe Rajonale PIU) së paku në tre muaj me raport të shkruar (përveç nëse nuk është dakorduar ndryshe me specialistin e mjedisit jetësor PLRK).



Publiku do të jetë i kyçur në procedurën për vlerësim të ndikimit të projektit përmes:

- (i) ekspozim të PNMJ së paku 14 ditë në uebfaqet relevante (të theksuara si më poshtë) të shoqëruar me thirrje për komente dhe adresa për kontaktim (postare dhe elektronike) dhe
- (ii) organizim të takimeve publike konsultative në hapësirat e Komunës së Strugës.

Plani për menaxhim me mjedisin jetësor dhe punë sociale për nën-projektin do të jetë i disponueshëm në formë të printuar në hapësirat e Komunës së Strugës dhe PLRK-së / CDPMEA dhe do të shpallet në ueb-faqen e PLRK-së, Agjencisë për promovim dhe përkrahje të turizimit dhe në ueb-faqen e Komunës së Strugës, ku do të jetë në këqyrje për publikun për periudhë kohore prej 14 ditëve. Për konsultë me publikun, forma e printuar do të jetë e disponueshme në hapësirat e Komunës së Strugës. Bashkë me PNMJ-në do të ketë edhe thirrje publike për pjesëmarrje në debat publik (me vend dhe kohë).

Takimi për debat publik do të organizohet në fund të periudhës për konsultime. Aplikuesi në mënyrë aktive do t'i informojë dhe do t'i ftojë palët e inkuadruara, në veçanti OJQ-të lokale, bashkësitë e interesit dhe personat përkatës. Do të emërohet person për kontakt, i cili do t'i grumbullojë komentet në lidhje me PNMJ-në dhe aspektet sociale, të dorëzuara gjatë periudhës së këqyrjes publike të Planit, si dhe për vendin dhe kohën e takimeve për konsultat publike dhe do t'i përfshijë në Raportin, i cili kdo të jetë pjesë e këtij Plani. Kjo do të mundësojë qasje deri te komentete për aplikuesit dhe do të merren parasysh komentet relevante dhe do të inkorporohen ato, si dhe vërjetjet në planin përfundimtar për menaxhim me mjedisin jetësor dhe aspektet sociale.

#### **4. NDIKIMET MBI MJEDISIN JETËSOR**

Në kuadër të nën-projektit “Struga – Destinacioni juaj turistik” i Komunës së Strugës, ekzistojnë rreziqe potenciale dhe ndikime negative të identifikuar si:

##### **4.1. RREZIQE PËR MJEDISIN JETËSOR DHE SHËNDETIN DHE SIGURINË E PUNËTORËVE**

Ndikimet e mëposhtme janë të indentifikuara si rezultat i aktiviteteve të nën-projektit “Struga – Destinacioni juaj turistik”:

1. Ndikime të mundshme negative mbi sigurinë dhe shëndetin e banorëve, vozitësve dhe punëtorëve (ndikime lokale të kofizuara në vendin e realizimit të aktiviteteve për zbatim të nën-projektit),

- Nuk priten ndikime negative mbi vendet e banimeve dhe mbi llojet e mbrojtura për shkak të rikonstruksionit të shtegut ekzistues për këmbësore dhe të ndërtimit të shtegut për biçikleta.

Këto ndikime janë afatshkurte, të pranishme vetëm gjatë fazës së implementimit dhe mund të paraqiten si rezultat i:

- Mungesës së masave të kujdesit të veçantë gjatë kryerjes së aktiviteteve,

- Lëndimit në vendin e punës ose në afërsi të vendit të punës (për shembull, mungesë e pajisjeve dhe veshjes mbrojtëse ose mangësi tjera të sigurisë në punë),

- Mosrespektimit të standarteve dhe procedurave të sigurisë në punë.

2. Është e mundur që të rriten rreziqet mbi mjedisin jetësor dhe mbi sigurinë në punë dhe rreziqet mbi shëndetin e qytetarëve nga mirëmbajtja joadekuate ose jo në kohë e makinave për furnizim të materialeve të punës të nevojshme për zbatim.

3. Emisione të gazrave nga mjetet transportuese dhe ndikimet mbi cilësinë e ajrit.

Këto ndikime janë lokale, të kufizuara në vendin e aktiviteteve për realizimin e nën-projektit dhe janë të pranishme vetëm gjatë zbatimit të aktiviteteve dhe mund të paraqiten për shkak të:

- emisionit të pluhurit nga transporti i materialeve të punës dhe nga menaxhimi me ato materiale,

- gazrave dalëse nga makinat dhe automjetet e rënda,

- si dhe nga shkaktimi i ndryshimeve në trafikun ekzistues.

4. Vibrime të mundshme dhe zhurmë si rezultat i mjeteve transportuese në atë rajon (këto janë zakonisht ndikime lokale të kufizuara gjatë zbatimit dhe janë të pranishme vetëm në fazën e implementimit).

5. Menaxhim joadekuat me mbeturinat dhe grumbullimi dhe transport jo në kohë i mbeturinave.

Efekte të padëshirueshme të mundshme mbi mjedisin jetësor dhe efekte negative shëndetësore mund të paraqiten si rezultat i prodhimit dhe menaxhimit me mbeturina (së pari mbeturina nga ndërtimtaria, drunj, metale, qelq, plastikë, mbeturina të rrezikshme, për shembull mbetje të bojrave, vajrave të përdorura).

6. Ndikime mbi tokën, ujërat mbitokësore dhe nëntokësore nga dalja, derdhja dhe nga aktivitetet joadekuate ndërtimore dhe menaxhim me mbeturina të rrezikshme.

Këto ndikime janë lokale (me mundësi të jenë rajonale, të varen nga menaxhmenti dhe nga mënjanimi/menaxhimi përfundimtar me lokacionin, të kufizuara në vendin e investimit. Gjithsesi, nëse nuk sigurohet menaxhim adekuat me mbeturinat në fazën operative, është e mundur që këto ndikime të jenë më afatgjate dhe të përsëritshme).

#### 4.1.1. EMISIONET NË AJËR

Faza e ndërtimit:

Në përgjithësi, emisionet në ajër mund të kategorizohen si:

- Emisione të padëshiruara. Këto emisioni nuk janë të emituara nga ndonjë pikë e caktuar burimore (të dala nga oxhaqet, gypat, ventilët ose nga sistemet e ajrosjes). Për shembull, për emision të padëshiruar llogaritet avullimi i ujërave të ndotura, emisioni i pluhurit nga toka e rrëmuar, emisionet nga përdorimi me materialet ndërtimore dhe me materiale të tjera, avullimi i ajrit nga kontenjerët e plehrave / kontenjerët / rezervaret dhe nga rrjedhjet incidente. Emisionet e padëshiruara llogariten edhe hapjet e ndërtesave (dyer dhe dritare).
- Pika të emisioneve. Këto emisione dalin në ajër përmes burimeve të vetme, për shembull, nga hapja e ventilacioneve, nga oxhaqet ose nga sistemet e ajrosjes. Burime të emisioneve të padëshiruara prite gjatë:

- realizimit të aktiviteteve të lokacionit, siç janë furnizimi i materialeve, rrëmimeve, menaxhimit të mbeturinave.

Edhe pse pritet që emisionet e padëshiruara të paraqiten gjatë realizimit të aktiviteteve të parashikuara për rikonstrukcion, emisionet e lartpërmendura të padëshiruara pritet t'i zmadhojnë emisionet që gjenerohen nga automjetet për furnizim me materiale dhe pajisje. Mbetjet që do të gjenerohen gjatë rikonstrukcionit dhe që do të mënjanojnë nga lokacioni, gjithashtu do të emitojnë, por potencohet se këto emisione do të jenë jonkonstante dhe periodike dhe do të llogariten si dukuri vizuale (duke e ditur atë dukuri) dhe të njëjtët do të kenë ndikim direkt mbi ajrin lokal. Ndikimi i gazrave mund të lë pasoja të njerëzimit të ekspozuar direkt ose në periudhë më të gjatë kohore përmes ndikimit direkt (thithje) dhe në mënyrë indirekte.

- Për shembull, pirja e cigareve ndikon te organet respiratore, si dhe te lëkura, kurse oksidet e karbonit ndikojnë si helme të fuqishme dhe si antioksidantë;
- Grimcat si prodhim i djegies së brendshme, gjithashtu mund të jenë të pritshme për shkak të aktiviteteve të rikonstrukcionit, por klasifikohen si ndikime afatshkurte dhe të përkohshme.

Faza operative:

Gjatë fazës operative te shtigjet e këmbësorëve dhe të biçikletave në rrugën “Partizanska” prej te prerja me rrugën “Korpusi i 15-të” deri te “Eurohoteli”, nuk pritet që të ketë emisione në ajrin lokal.

#### 4.1.2. EMISIONE NË UJË DHE NË SISTEMET PËR MËNJANIM TË UJËRAVE

Faza e ndërtimit:

Gjatë punëve të parashikuara për rikonstrukcion nuk pritet të gjenerohen sasi të mëdha të ujërave të ndotura, por do të theksojmë se ujërat e ndotura sanitare që prodhohen nga punëtorët, do të grumbullohen në tualete lëvizëse (të tipit TOI).

Nuk pritet të krijohen llojet tjera të ujërave të ndotura. Disa ndikime negative mbi ujërat e nëndheshme dhe sipërfaqësore janë të mundshme të paraqiten te lokacioni i nën-projektit, si rezultat i:

- Depozitimit joadekuat të materialeve të punës;
- Mënjanimi jo i drejtë i mbeturinave nga lokacioni për rikonstrukcion.

Faza operative:

Gjatë fazës operative te shtigjet e këmbësorëve dhe të biçikletave në rrugën “Partizanska” prej te prerja me rrugën “Korpusi i 15-të” deri te “Eurohoteli”, nuk pritet që të ketë derdhje në ujëra nëntokësore dhe mbitokësore, si dhe në kanalizim.

#### 4.1.3. KRIJIMI I MBETURINAVE

Krijimi i mbeturinave pritet edhe gjatë realizimit të këtij nën-projekti.

Faza e ndërtimit:

Materialet si mbeturina që pritet të krijohen, zakonisht do të jenë si sasi të vogla të tokës të gërmuar.

Lloj tjetër i mbeturinave mund të shfaqet në formë të mbeturinave mikse komunale, mbeturinave nga ndërtimtaria dhe demolimi dhe mbeturina nga ambalazhimi, si dhe sasi të vogla të mbeturinave të rrezikshme siç janë veshjet e vajosura, peshqire dhe pajisje dhe mbeturina nga ambalazhet e vajrave dhe yndyrnave, kurse në fazën operative nuk pritet që të ketë lloje tjera të mbeturinave, përveç mbeturinave mikse komunale dhe mbeturinave nga paketimi.

Ky ndikim llogaritet si i mesëm, lokal dhe i përkohshëm, vetëm gjatë aktiviteteteve për rikonstrukcion.

**Tabela nr.1 – Lloje të mbeturinave**

Nr.	Lloji mbeturinave	Numri i listës për llojet e mbeturinave (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.100/05	Sasia e mbeturinave vjetore e shprehur në tonelata ose litra	Mënyra e trajtimit të mbeturinave (përpunimi, depozitimi, dorëzimi, mënjanimi etj.)	Emri i personit juridik, i cili menaxhon me mbeturinat dhe emri i vendit ku depozitohen mbeturinat (landfilli)
1.	Mbetje nga	17 06 04	643.79 m <sup>3</sup>	Përkohësisht do	Marrëveshje me

	materialet ndërtimore			të ruhen në vend të posaçëm, kurse më tej do të mënjahohen në landfill përkatës	kompani të licencuar për menaxhim më këtë lloj të mbeturinave
2.	Materiale të ndryshme nga ndërtimi të paspecifikuara në 17 09 02 dhe 17 09 03	17 09 04	Do të përcaktohet gjatë punëve	Përkohësisht do të ruhen në vend të posaçëm, kurse më tej do të mënjahohen në landfill përkatës	Marrëveshje me kompani të licencuar për menaxhim më këtë lloj të mbeturinave
3.	Drunj, qelq dhe plastike	17 08 02	Do të përcaktohet gjatë punëve	Përkohësisht do të ruhen në vend të posaçëm, kurse më tej do të mënjahohen në landfill përkatës	Marrëveshje me kompani të licencuar për menaxhim më këtë lloj të mbeturinave/ riciklimi nuk është i mundshëm
4.	Letër dhe ambalazhë kartoni	15 01 01	Do të përcaktohet gjatë punëve	Do të ruhet përkohësisht në lokacion deri në momentin e dorëzimit të personi i autorizuar juridik	Do të rregullohet me marrëveshje të veçantë në baza tregtare me person të licencuar juridik, nëse riciklimi ose përdorimi i sërishëm nuk është i mundur
5.	Ambalazhë plastike	15 01 02	Do të përcaktohet gjatë punëve	Do të ruhet përkohësisht në lokacion deri në momentin e dorëzimit të personi i autorizuar juridik	Do të rregullohet me marrëveshje të veçantë në baza tregtare me person të licencuar juridik
6.	Mbeturina mikse komunale	20 03 01	0.002 t / person	Do të ruhet përkohësisht në lokacion deri në momentin e dorëzimit të personi i autorizuar juridik	Kompani i licencuar për menaxhim më këtë lloj të mbeturinave
7.	Ambalazh nga bojrat dhe llaqet, peshqire të yndyrshme dhe mbeturina të tjera		Do të përcaktohet gjatë punëve	Do të ruhet përkohësisht në lokacion deri në momentin e dorëzimit të personi i autorizuar juridik	Do të rregullohet me marrëveshje të veçantë në baza tregtare me person të licencuar juridik

**Faza operative:**

Gjenerimi i mbeturinave në fazën operative do të jetë i gjatë kohës së qëndrimit të turistëve në lokacione, Ndikimi vlerësohet si më i vogël, lokal dhe në kontinuitet.

#### 4.1.4. EMISIONET E TOKËS

##### **Faza e ndërtimit:**

Duhet të mirret parasysh fakti se rekonstruimi do të kryhet në lokacionin ku paraprakisht është ndërtuar infrastrukturë adekuate dhe gjatë implementimit të aktiviteteve në praktikë do të zbatohet praktikë e duhur ndërtimi. Ndikimet mbi token mund të dalin nga menaxhimi jo I duhur me ujrat e zeza nga tualetet e lëvizshme, mbeturinat e gjeneruara dhe gazrat shkarkuese të automjeteve. Gjatë kohës së implementimit të aktiviteteve, nuk pritet rrjedhje e emulzioneve, përzierjeve të betonit, vaj dhe lëndët djegëse.

Megjithatë nëse paraqiten cilido nga problemet e përmendura do të ndërmerren masa konform Planit për zbutje dhe monitoring.

Humusi I cili do të përdoret/vendoset për përfundimin e shtegut për këmbësorë dhe biçikleta duhet të jetë me prejardhje lokale, një pjesë e lokacionit ku do të kryhet ndërtimi dhe një pjesë në afërsi të lokacionit për ndërtim që do të zënë, janë të përfshira në përlogaritje për sasi prej 276.19m<sup>3</sup>.

Ndikimi I tokës në gjatë fazes së ndërtimit ishte vlerësuar si negative, por e papërfillshme, locale dhe e përkohshme.

##### **Faza operative:**

Puna e shtegut për këmbësorë dhe për biçikleta në rrugën „Partizanska,, deri te prerja e rr.,„15 Korpus,, e deri te „Euro hoteli,, nuk do të shkaktojë ndotje të tokës

#### 4.1.5. ZHURMA, VIBRACIONE DHE RREZATIM JO-I JONIZUAR

##### **Faza e ndërtimit**

Realizimi I nën-projektit është I lidhur me një sere aktiviteteve të cilat shkaktojnë zhurmë. Zhurma zakonisht shkaktohet për shkak të punës së maqinerive të ndërtimit dhe pajisjes e cila përdoret. Nivelet e zhurmës do të jenë të ngjajshme me ato tipike për kantierat e ndërtimit ose aktiviteteve siç janë pastrami, rrërimi, vendosja e shtresës së tamponit e tj.

Zhurma nga aktivitete për rekonstruim so të jenë locale dhe të përkohshme dhe nivelet do të jenë të pabarabarta dhe alternative.

<b>Извор на бучава/ Burimi I zhurmës</b>	<b>Ниво на бучава(dBA) за 15м од Изворот/ Niveli I zhurmës(dBA) për 15 m nga burimi</b>
Бетонско мешање/Пërzierje e betonit	85
Камион/Кamion	84
Алати за бушење/Мjete për shpuarje	85
Сечење на метал/Прerje e metalit	90
Багери /eskavator	85

**Burim: Ministria për transport e SHBA, Administrata federale e autostradave – Nivelet dhe volume I zhurmës në kantierën e ndërtimit**

Ndikimet mbi fuqinë puntore e cila do të jetë e angazhuar nuk priten që të jenë të konsiderueshme, pasi që niveli I zhurmës gjatë aktiviteteve për rekonstruim do të jetë afatshkurtër.

Ndikimi I zhurmës gjatë fazes së ndërtimit do të jetë me madhësi mesatare, locale dhe e

përkohshme.

Vlerat kufitare janë pranuar sipas rregullativave ligjore positive (konform Rregullores për vlera kufitare në nivel të zhurmës në mjedisin jetësor, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.147 të dates 26.11.2008)

Vlerqat kufitare janë sin ë vijim:

Vlerqat kufitare janë sin ë vijim:

Област деф. Со степенот на заштита од бучава Zona e def. me shkallën e mbrojtjes nga zhurma	Ниво на бучава изразено во dB (A) Niveli I zhurmës I paraqitur në dB (A)		
	ЛД/LD (07-19h)		ЛД/LD (07-19h)
Област од прво Ниво/Zona e nivelit të parë	50	Област од прво Ниво/Zona e nivelit të parë	50
Област од второ Ниво/Zona e nivelit të dytë	55	Област од второ Ниво/Zona e nivelit të dytë	55
<b>Област од трет Степен/Zona e nivelit të tretë</b>	<b>60</b>	<b>Област од трет Степен/Zona e nivelit të tretë</b>	<b>60</b>
Облас од четврти Степен/Zona e nivelit të katërt	70	Облас од четврти Степен/Zona e nivelit të katërt	70

Legjenda:

- D –Koha ditore, P – Pasdite; M– Mbrëmje;

-Zona e nivelit të pare është e destinuar për turizëm, rekreacion, afërsi të institucioneve shëndetësore dhe spitalore, parqet nacionale dhe rezervatet natyrore.

-Zona e nivelit të dytë është së pari e destinuar për banim dhe zonë banimi, objekte të dedikuara për aktivitete arsimore, institucione për mbrojtje sociale, akomodim për fëmijë dhe persona të moshuar, etj.

-Zona e nivelit të tretë është e destinuar si zone komerciale-banimi dhe afariste ose sipërfaqe e përzier për aktivitete artizanale dhe aktivitete të ngajshme dhe sipërfaqe e destinuar për veprimtari bujqësore, shërbime tregtare, hotelieri etj.

-Zona e nivelit të katërt është zone pa ndërtesa banimi dhe fillimisht është e destinuar për aktivitete artizanale dhe industrial si dhe aktivitete për prodhim.

Aktivitetet e projektit nddhen në zonën e tretë për mbrojtje nga zhurma.

### **Faza operative:**

Nuk pritet ndikim më i madh i zhurmës për shkak të natyrës së aktiviteteve të cilat duhet të kryhen në fazën operative të nën-projektit.

Sipas natyrës së aktivitetit dhe aktiviteteve gjatë fazes operative nuk do të shkaktohen vibracione të dëmshme.

Nuk ka burime të rrezatimeve të pa-jonizuara në afërsi të shtegut për këmbësorë dhe biçikleta, si dhe në lokacionin afër tyre.

### **4.1.6. BIODIVERSITETI (FLORA DHE FAUNA)**

#### **Faza e ndërtimit**

Aktivitetet e projektit janë në distance të ndryshueshme prej 20 deri në 30 metra nga Liqeni i Ohrit, zona buzë bregut të liqenit do të jetë e mbrojtur me rrjet të sigurisë dhe nuk do të ketë qasje.

Aktivitetet për rekonstruim nuk parashohin ndikime të shprehura si humbje e biodiversitetit. Duke pasur parasysh se aktivitetet nën-projektit ndodhen në zone urbane, nuk priten ndikime negative për florën dhe faunën në tokë. Gjatësia e gropave të shtegut është në kufijtë e qytetit të Strugës dhe distance më e largët deri te lokaliteti sipas vlerave univerzale (flora dhe fauna ujore dhe pjesërisht avifauna) është përafërsisht 5km (vendi Kalisht) siç është paraqitur në fotografinë nr.1. Ndikime afatshkurtra të ndryshueshmërisë biologjike (çrregullime të vogla) janë të mundura në raport me lokacione specifike gjatë ndërtimit të aktiviteteve (mund të paraqitet rritje afatshkurtër i zhurmës gjatë kryerjes së aktiviteteve).

Në raport me florën dhe faunën ujore ekziston mundësia për paraqitjen e ndikimeve negative nga aktivitetet në vijim:

- Mënjanim i trotuarit në shtigjet ekzistuese (në rast të menxhimit të keq dhe ruajtjes jo të duhur të mbeturinave të krijuara)
- Asfaltim i shtegut për biçikleta përmes përdorimit të maqinerive të rënda dhe mundësisë për rrjedhjen e bitumenit, mazutit dhe vajrave në tokë në afërsi relative të bregut të Liqenit të Ohrit.

Këto ndikime mund të vlerësohen si afatmesme, të matura dhe locale si rezultat i vëllimit dhe madhësisë së aktiviteteve të nën-projektit.

Për shkak të largësisë relative nga Liqeni i Ohrit (20-30m) nuk ekziston rrezik i madh i drejtpërdrejtë nga derdhja që do të shkaktojë ndikime të konsiderueshme të llojllojshmërisë biologjike në Liqenin e Ohrit. Gjithsesi, masat preventive dhe ato zbutëse janë të kyçura që të minimizojnë dëmet në rast të këtij incidenti.

#### **Faza operative**

Zona e mbrojtjes së natyrës (trashëgimia natyrore, raritetet natyrore dhe zona me llojllojshmëri biologjike) duhet të harmonizohet ashtu që në bazë të regjimit mbrojtës, do të organizohet orar i aktiviteteve që të plotësohen kërkesat e përcaktuara me të, përdorim i qëndrueshëm i natyrës

Dhe trajtim bashkëkohor me konservim.

Vëmendje e posaçme i është kushtuar mbrojtjes së natyrës gjatë vlerësimit të mënyrës, llojit dhe vëllimit të aktiviteteve të parapara në këto zona, që ti shmangen ose të tejkalohen konfliktet dhe përplasjet me funksionet kompatible. Për këtë qëllim janë respektuar principet në vijim:

- Mbrojtje optimal e zonave me vlerë të jashtzakonshme
- Mbrojtje dhe përtrirje e ekzistencës së biodiversitetit dhe llojllojshmërisë së zonave në gjendje të baraspeshës natyrore
- Sigurim i përdorjes së qëndrueshme të trashëgimisë kulturore në interes të zhvillimit aktual dhe të ardhshëm pa dëmim të konsiderueshëm të pjesëve natyrore edhe atë me minimizim të çrregullimeve të baraspeshës natyrore.
- Parandalimi i aktiviteteve të dëmshme të personave fizik dhe juridik dhe çrregullimeve natyrore si rezultat i kryerjes së aktiviteteve , përkatësisht sigurimit të kushteve më të volitshme për mbrojtjen dhe zhvillimin e natyrës.

#### 4.1.7 NDIKIMI I PEJSAZHIT

Ndjeshmëria e zonës, vlera e lartë e vlerave natyrore dhe të krijuara të rajonit nënkupton nevojën e zgjidhjeve për planifikim me vëmendje të posaçme në:

- Promovimin dhe mbrojtjen e mjedisit,
- Mbrojtje e vlerave ekologjike, funksioneve dhe shumllojshmërinë biologjike në këtë rajon.

Ndikimet në politikën hapësinore mund të jenë të rëndësishme nëse kryhet mirëmbajtje e pakontrolluar dhe joadekuate e territorit Brenda dhe jashtë lokacionit.

Aktivitetet për rekonstruim mund të shkaktojnë ndikime negative si rezultat i rrëmimit të tokës dhe mënjanim të tokës së tepërt në lokacione joadekuate.

Këto ndikime priten të trajtohen si ndikime negative, por ato do të jenë me intensitet dhe kohëzgjatje të kufizuar. Zhvillimi i turizmit nënkupton mbrojtje të ambientit jetësor për shkak se zhvillimi i turizmit nuk është i mundur në mjedis ku raportet e ekosistemit janë të çrregulluara.

Turizmi duhet ta mbrojë hapësirën nga aktivitete të paplota të cilat vijnë në përplasje hapësinore, por edhe me vetveten, me qëllim që të mbrohet resursi i cili bazohet zhvillimi i tij. Njëra nga mënyrat më të rëndësishme për kontrollimin e zhvillimit hapësinor të turizmit është përcaktimi i kapaciteteve bartëse të hapësirës turistike.



Sipas konceptit dhe kriterëve për zhvillim dhe menaxhim me aktivitete turistike për zhvillim të vazhdueshëm të ofertës së tërësishme turistike në këtë zone, rekomandohen që rregullativat e ardhshme ti respektojnë kriteret për mbrojtje dhe zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.

Realizimi i këtij lloji të rekonstruimit duhet të gjenerojë impulse dhe efekte pozitive mbi gjithë rrethinën nga aspekti i përdorimit të qëndrueshëm, organizim më të lartë, pajisje infrastrukturore, kualitet dhe shërbime më të larta për mjedisin jetësor, si dhe dizajn i hapësirës e bazuar në principe të qëndrueshme, reference si respektim maksimal dhe përfshirje e ligjeve për mjedisin jetësor dhe standardet për rërë.

Me implementimin e këtyre aktiviteteve projektuese nuk priten ndikime të konsiderueshme ndaj lokacionit dhe rrethinës më të gjerë.

infrastructure equipment, higher quality of environmental services, as well as space design based on sustainable principles, development as well as maximum respect for and incorporation of environmental law and standards.

With the implementation of these project activities, no significant impacts are expected on the site location and the wider environment.

#### **4.2. GJENDJA SOCIO-EKONOMIKE E ËRGJITHSHME**

Për qëllimet e këtij nën-projekti nuk ka eksproprijim të tokës private për shkak se të gjitha parcelat kadastrale janë në pronësi të shtetit.

Gjatë gjithë rutës toka është në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në tërësi realizimi i gjithë këtij nën-projekti do të rezultojë me ndikime pozitive mbi zhvillimin socio-ekonomik të cilat do të arrihen përmirësimin të klimës së biznesit, mundësi për zhvillim të biznesit dhe tregëtisë dhe krijimi i vendeve të reja të punës.

Realizimi i këtij projekti pritet që të shkaktojë impulse dhe efekte pozitive mbi gjithë rrethinën në raport me planifikimin hapësinor të duhur dhe gjithashtu efekte ekonomike për komunën e Strugës si dhe rajonin më të gjerë.

#### **5. MASAT PËR SHMANGJE, ZBUTJE DHE REDUKTIM TË NDIKIMEVE MBI MJEDIDIN JETËSOR**

Masat për zbutje të përshkruara në këtë pjesë janë masa të përgjithshme, masat detyruese për zbutje janë shtuar në kapitullin e Planit për zbutje dhe monitorim.

Masat për shmangje dhe zbutje të ndikimeve mbi mjedisin jetësor dhe aspektet sociale të nën-projektit do të kufizohen në:

- Informata në kohë reale deri te banorët local për fillimin e aktiviteteve të rekonstruimit,
- Shënimi i duhur i lokacionit të rekonstruimit

- Shënimi I lokacionit për magazinimin e përkohshëm të materialeve,
- Vendosja e lentave për paralajmërim, rrethim dhe shenja (me qëllim që të ndalohet qasja e të punësuarve dhe pajisjeve të kantierës së ndërtimit deri te brezi I bregut të Liqenit të Ohrit)
- Ndalim për hyrje në hapësirën e shënuar me lenta për paralajmërim, aplikim dhe masa për sigurinë e qytetarëve,
- Me maqineritë do të menaxhojnë vetëm anëtarë me përvojë dhe të trajnuar të personelit,
- Pjesmarrje e aparateve kundër zjarrit në rast zjarri dhe dëme të tjera,
- Çuarje e vazhdueshme e pajisjeve dhe veshjeve mbrojtëse,
- Lëgjet duhet të ruhen ekskluzivisht në kontenjer të bërë për atë qëllim.

Zbatimi I masave është I detyrueshëm që të arrihet menaxhim adekuat me mbeturinat dhe mbledhje dhe transport I përkohshëm I mbeturinave që të shmangen rreziqet dhe të zvogëlohen ndikimet e identifikuar mbi ambientin jetësor, banorët local, vizitorët dhe fuqia puntore e angazhuar.

-Rrethi duhet të jetë I pastër, pa asnjë mbeturinë. Mbeturinat duhet të mblidhen dhe të transportohen menjëherë jashtë vendit ku kryhen punët ndërtimore dhe rekonstruimi.

-Orari I mirëmbajtjes së lokacionit duhet të rritet për shkak të mbaturinave shtesë nga aktivitetet e punës,

-Mbeturinat do të klasifikohen dhe menaxhohen konform Ligjit nacional për menaxhim me mbeturina (ndarje në vendndodhje, mbledhje dhe ruajtje e përkohshme, transport deri në destinacionin e fundit – deponia legale),

-Gjatë kohës së aktiviteteve mund të krijohen sasi të vogla të yndyrërave dhe mbetjeve nga vajrat, bashkë me mbeturinat nga paketimi, bojra dhe material të tjera ndërtimore dhe duhet të menaxhohen konform legjislacionit nacional për menaxhim me mbeturinat.

(mbledhje e materieve të rrezikshme në kontejner të posaçëm për këtë qëllim, të shënohet si mbetje e rrezikshme dhe të dorëzohet deri te kompania e autorizuar),

- Realizuesi do ti mbledhë dhe dorëzojë dhe/ose do ti transportojë mbeturinat sipas marrëveshjes së lidhur.

Identifikimi, klasifikimi dhe ruajtja e veçantë e përkohshme (në kontejner të posaçëm të shënuar në lokacione të caktuara paraprakisht dhe në numrin e duhur) për lloje të ndryshme të mbeturinave të krijuara nga rehabilitimi dhe menaxhimi me mbeturinat. Mbeturinat mund të bartend he përpunohen nga kompani të licencuara.

Sa I përket sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës (duke përfshirë edhe sigurinë e përgjithshme të komunitetit dhe vizitorëve), masat e propozuara zbutëse janë sin ë vijim:

-Shirita adekuat për paralajmërim dhe tabela informative për objektet gjatë kohës së punëve ndërtimore,

Për punëtorët: të aplikohen masat e parapara ligjore për siguri dhe shëndet, siç janë:

a)Përdorimi I pajisjeve dhe veshjeve mbrojtëse personale

b)Furnizim dhe posedim I mbrojtjes shëndetsore – ndihma e pare e lokacionit për realizim,

Të gjithë punëtorët duhet të jenë të vetëdijshëm për të gjitha rreziqet dhe masat për mbrojtje kundër zjarrit dhe duhet të jenë të trajnuar të përdorin aparate kundër zjarrit, hidrante dhe pajisje kundër zjarrit të cilat duhet të jenë funksionale.

Që të zvogëlohet zhurma duhet të aplikohen masat zbutëse sin ë vijim:

-Për shkak të lokacionit niveli I zhurmës nuk duhet të tejkalojë 50 decibel gjatë ditës dhe 40 decibel gjatë natës,

-Është e ndaluar puna ndërtimore gjatë orëve të natës, aktivitetet ndërtimore të lokacionit duhet të jenë të kufizuara nga ora 7.00 deri në ora 19.00.

-Përdorimi I materialit adekuat, pajisjeve dhe mjeteve të cilat e zvogëlojnë nivelin e zhurmës. Niveli I zhurmës nuk guxon të tejkalojë 50 decibel gjatë ditës dhe 40 decibel gjatë natës, ndërsa punët nuk do të realizohen **gjatë natës**.

Vendosjen e një regjimi të veçantë të komunikacionit për automjetet e realizuesit, gjatë aktiviteteve të rekonstruimit dhe aktiviteteve ndërtimore me sinjalizimin adekuat.

Nënshkrimi i një kontrate me një kompani për mirëmbajtjeje të rregullt, zëvendësimin e pjesëve, nderimin e karburantit, mirëmbajtjen e duhur (shter dhe makinën dhe sigurim për shembull: frenat, gomat, etj.) Si një nga karakteristikat më të rëndësishme të sigurisë, pastrimi në kohë dhe mirëmbajtja e automjeteve në lokacionet për parkim, ndalimi i ndërrimit të naftës dhe karburantit në vendngjarje për të shmangur ndotjen e ujit dhe tokës, zbatimin e provës - testit vjetore për miratim gjatë regjistrimit vjetor të automjeteve.

Zbatimin e planit për menaxhim me mjedisin jetësor dhe sigurimin social do të sigurojë zbatimin në kohë të masave të propozuara që do të mundësojnë realizimin e aktiviteteve të projektit të mos kenë ndikime të rëndësishme në mjedis jetësor.

Komuna do të raportojë për gjendjen e mjedisit jetësor dhe zbatimin e masave lehtësuese dhe monitoruese në raportet e rregullta të progresit të nën-projektit dhe në raportin e veçantë për zbatimin e Planit për Menaxhim me Mjedisin jetësor dhe aspektit social në bazë kuartale nga ekspert i mjedisit jetësor ( Nëse nuk është rënd dakord për mënyrë tjetër me Ekspertin e Mjedisit jetësor, aprovuar nga Specialisti.

<b>Mitigation plan</b>					
<b>Preparatory phase</b>					
Aktivitetet	Ndikimet e pritura mbi mjedisin jetësor	Masë e propozuar për zbutje	Përgjegjës për zbatimin e masës për zbutje	Periudhë për zbatimin e masës për zbutje	Shpenzime të lidhura me zbatimin e masës për zbutje
1. Ndërtimi i shtegës për biçikleta dhe zgjerimi i shtegës ekzistuese për këmbësor	Ndikim social negative dhe shëndetësor mbi banoret lokal dhe punëtorët si rezultat i mosrespektimit i masave të përcaktuara të sigurisë	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Planifikimi i fillimit të aktiviteteve të nën-projekteve</li> <li>- Publiku është i informuar për fillimin e aktiviteteve të nën projektit.</li> <li>- Të gjitha lejet, mendimet dhe zgjidhjet e nevojshme janë marrë para fillimit të punimeve; - Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe të gjitha shërbimet e tjera janë njoftuar për zbatimin e aktiviteteve përpara se ato të zbatohen.</li> <li>- Punimet dhe aktivitetet e punës kryhen në mënyrë të sigurt dhe të disiplinuar;</li> <li>- Aktivitetet e rindërtimit duhet të kryhen në përputhje me rregulloret kombëtare dhe standardet ndërkombëtare të sigurisë</li> </ul>	<p>Realizuesi:</p> <p>Do të ketë mbi mbikëqyrje Punëtorët administrativ, duke i përfshirë edhe ( Inspektorët komunal ose inspektor për mjedisin jetësor.</p>	Para se të fillojnë me projektet dhe aktiviteteve	Përfshirë në koston e ndërtimit
<b>Phase of reconstruction</b>					
Aktivitetet ,	Ndikimet e pritura mbi mjedisin jetësor	Masë e propozuar për zbutje	Përgjegjësi për zbatimin e masave për zbutje	Periudhë kohore për zbatimin të masave për zbutje	Shpenzime të lidhura me zbatimin për zbutjen e masave
1. Të gjithë aktivitetet	Ndikim negative social dhe shëndetësor mbi banoret lokal dhe punëtorët si rezultat i mosrespektimit i masave të përcaktuara	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Punët dhe aktivitetet punuese duhet të zhvillohen në mënyrë të sigurt dhe të rregullt</li> <li>- Shtegat do të ndërtohen në pajtim me dispozitat nacionale dhe standardet për sigurim</li> <li>-</li> </ul>	<p>Realizuesi:</p> <p>Do të ketë mbi mbikëqyrje Punëtorët administrativ, duke i përfshirë edhe</p>	Para se të fillojnë me projektet dhe aktiviteteve	Përfshirë në koston e ndërtimit

	të sigurisë		(Inspektorët komunal ose inspector për mjedisin jetësor.		
2.Të gjithë aktivitetet	Ndikim negative social dhe shëndetësor mbi banoret lokal dhe punëtorët si rezultat i mosrespektimit i masave të përcaktuara të sigurisë	<p>Informacion i përbashkët nga media lokale në lidhje me aktivitetet e ndërtimit për kryerjen e rindërtimit</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- fillimin dhe përfundimin e punës për çdo ditë dhe vendndodhjen e saktë të aktiviteteve, kohëzgjatjen e punës;</li> <li>- Të sigurohen vendeve adekuate të ku do të kryhen punimet në ndërtim duke vendosur një tabelë në vendin me të dhëna të përgjithshme të projektit, dhe emrin dhe mbikëqyrjen e kontraktuesit;</li> <li>- Shenjat/ tabelat informuese nuk duhet të dikojnë në sigurinë dhe dukshmërinë në komunikacion</li> <li>- Sigurimi i shiritave dhe shenjave për paralajmërim ;</li> <li>- “Ndalesë për hyrje” të personave që nuk janë punëtor.</li> <li>- Masa për sigurim të këmbësorëve. Kushtim të veçantë në sigurim të fëmijëve dhe personave të moshuar.</li> <li>- Masa për mbrojtje të punëtorëve (ndihma e parë, veshje mbrojtës dhe pajisje për punëtorët, p.sh. Helmetet, doreza etj.</li> <li>- Pajisja për ndihmën e shpejt do të jetë e</li> <li>- Pajisjet e ndihmës së parë- shpejtë do të jenë të disponueshme në vend dhe punëtorët duhet të aftësohen për ta përdorur atë;</li> <li>- Makineritë e ndërtimit do të menaxhohen vetëm nga një persone me përvojë dhe të trajnuar siç duhet, - të gjithë punëtorët duhet të</li> </ul>	<p>Realizuesi: Do ti ketë mbi mbikëqyrje Punëtorët administrativ, duke l përfshirë edhe (Inspektorët komunal ose inspector për mjedisin jetësor.</p>	Para se të fillojnë me projektet dhe aktiviteteve	Përfshirë në koston e ndërtimit

		<p>jenë të vetëdijshëm për rreziqet e zjarrit dhe për masat e sigurisë kundër zjarrit dhe duhet të jenë të trajnuar të punojnë me aparatet e zjarrit, hidratuesit dhe të tjera që shfrytëzohen për shkuarjen e zjarrit.</p> <p>- Pajisjet, pajisjet dhe aparatet e zjarrit duhet të jenë gjithmonë funksionale në rast se duhet të përdoren shpejt dhe me efikasitet;</p> <p>- Punëtorët duhet të jenë të trajnuar, të certifikuar dhe me përvojë në punën që do të ndërmarrin.</p>			
	Menaxhim dhe transport i materialeve	<p>- Materialet e reja që jeni të përdorura nuk do të përmbajnë asbest ose ngjyra me bazë plumbi;</p> <p>- agregati që do të përdoret dhe vendoset në beton duhet të përputhet me kërkesat e qëndrueshmërisë dhe qëndrueshmërisë;</p> <p>- Agregati duhet të jetë e re (të mos jetë e përdorur më parë) dhe rekomandohet të prodhohet në vend;</p> <p>Burimet minerale (agregat, rërë, zhavorr, etj) prodhohen vetëm nga kompani të licencuara me koncesione të vlefshme ekstraktimi / shfrytëzimi .</p>	<p>Realizues :</p> <p>Inzhinieri Mbikëqyrës</p> <p>Do ti ketë mbi mbikëqyrje Punëtorët administrativ, duke I përfshirë edhe (Inspektorët komunal ose inspector për mjedisin jetësor.</p>	Gjatë ndërtimit	Përfshirë në koston e ndërtimit
	Emisione në ajër (Aktivitetet do të iniciohen prodhimi i gazrave të shkarkimit dhe pluhurit nga grimcat e pezulluara:  - ngrimca e pluhurit në lidhje me	<p>mekanizim që nuk duhet të jetë më i vjetër se 15 vjet dhe ta shuajnë mekanikën e motorit që nuk është në përdorim, për të zvogëluar emetimet e shkarkimit të gazrave;</p> <p>- Planifikimi i transportit – ngarkim dhe shkarkim;</p> <p>- Përdorimi i spërkatësve që janë në bazë me ujë që nuk përmbajnë kimikate;</p>	<p>Realizues Do ti ketë mbi mbikëqyrje Punëtorët administrativ, duke I përfshirë edhe (Inspektorët komunal ose inspector për</p>	Gjatë ndërtimit	Përfshirë në koston e ndërtimit

	<p>punimet e ndërtimit</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Emetimet e shkarkimeve nga burimet e lëvizshme (NOx, SO2, tymi) nga përdorimi i makinerive ndërtimore për rindërtim - do të çojnë në ndotje;</li> <li>- Emetimet e pluhurit që do të vijnë nga heqja e betonit dhe tokës</li> <li>- emetimet e pluhurit që do të ndodhin gjatë ngarkimit dhe transportimit të materialit tashmë të gërmuar..</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndërprerja e punës ose zvogëlimi i orarit të punës, Të shfrytëzohen Karburantet e standardizuara nëse regjistrohet një emetim intensiv i pluhurit, në mënyrë që të përcaktohet shkaku i emetimit dhe të merren masa për ta eliminuar atë;</li> <li>-Shpejtësia e lëvizjes së automjeteve do të jetë e kufizuar në 30 km / orë;</li> <li>Automjetet që transportojnë zhavorr, rërë, tokë dhe materiale të tjera rindërtimi duhet të mbulohen ose mbyllen;</li> <li>- Materialet e ndërtimit do të ruhen në vende të përshtatshme, të mbuluara, për të minimizuar pluhurin;</li> <li>- Përdorimi i masave mbrojtëse të punëtorëve i detyrueshëm nëse shfaqet pluhur.</li> </ul>	<p>mjedisin jetësor.</p>		
	<p>Ndotja e ujit, uji nëntokësor dhe toka nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kullimi i përkohshëm i pakontrolluar i ujit sipërfaqësor për shkak të aktiviteteve të rekonstruimit;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Realizuesi duhet të instalojë tualete të lëvizshme për punëtorët, që do të pastrohen dhe mirëmbahen vazhdimisht.</li> <li>-Riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve dhe makinerive do të bëhet vetëm në sallone të autorizuara të makinave. Automjetet dhe makineria do të parkohen në sipërfaqe me sistem për kullimi dhe kanalizimi;</li> </ul>	<p>Contractor; Supervision of municipal staff as well (communal inspector / inspector of environment); - Ministry of Environment and</p>	<p>During construction</p>	<p>Included in cost of performance</p>

